



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:128889

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05649494

KE.nr.876/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit NPSH Allmakes Global Services, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valdrin Behrami, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit NPSH Allmakes Global Services, kundër të paditurit K.S. "Siguria" Sh.A., lënda me numër KE.nr. 876/22 (2020:128889), me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi NPSH Allmakes Global Services, me datën 01.04.2016, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për kompensim dëmi, me vlerë kontesti 1,636.74€, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A.

Gjykata me datë 15.04.2024 ka caktuar seancë përgatitore, në të cilën ka prezantuar vetëm përfaqësuesi i paditësit dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës me arsyetimin se janë afër arritjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore me paditësit, për çfarë gjykata ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe seancën e shtyrë për datën 02.05.2024 për të cilën seancë është njoftuar përmes konstatimit në procesverbal.

Në seancën e datës 02.05.2024 nuk kanë prezantuar përfaqësuesit e paditësit dhe të paditurit edhe pse të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 876/22, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.